



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivered	28.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt. Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	6555/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.753/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.753/2022 të datës 31.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.753/2022 e datës 31.08.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Akti. Nr.17/2022 i datës 03.08.2022 i Zëvendësueses së Udhëheqëses të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore si dhe Akti i Emërimit AE.nr.01/2022 i datës 03.08.2022.

III. Shfuqizohet Vendimi me numër A.nr.902/2021 i datës 17.12.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.574/2021 të datës 07.06.2022 me datën 03.08.2022 ka marr vendimin me numër Akti. Nr.17/2022 me te cilin

vendim e ka anuluar vendimin me Nr.14/2021 të datës 09.09.2021 për emërimin e ankuesit në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër Akti.nr.17/2022 të datës 03.08.2022 të Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë me datën 31.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5046/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës duke i propozuar KPMSHCK-se që ta aprovoj ankesën e ankuesit, ta anuloj vendimin Akti.nr. 17/2022 të datës 03.08.2022 si dhe ta detyroj KKTK-në të bëjë zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së A.nr.902/2021 të datës 17.12.2021 dhe të më kompensoj diferencën në pagë sipas këtij vendimi nga muaji shtator 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.09.2022 ka dërguar kërkesën me numër të protokollit 5154/2022 për përgjigje në ankesë të ankuesit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimit Kulturorë, ndërsa më datë 16.09.2022 kemi pranuar përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5432/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes me Vendimin Nr.123/2022 të datës 14.10.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A753/2022 të datës 31.08.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Sipas kërkesës së Kryetares së Kolegjit, me datë 14.10.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK.nr.123/2022 përmes të cilit ankesës së ankuesit Isuf Koci A.nr.753/2022 të datës 31.08.2022 i ka shtyrë afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë punë, me qëllim të shqyrtimeve shtesë të lëndës për shkak të specifikave të saj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5046/2022 të datës 31.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, të Kosovës; Vendimin me numër Akti.nr.17/2022 të datës 03.08.2022 të Z.v. Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë; Vendimin me numër Akti.Nr.14/21 të datës 09.09.2021; Akt emërimin me numër AE.Nr.04/2021 të datës 09.09.2021; Vendimin me numër 02/2018 të datës 29.01.2018; Kërkesën për sqarim me numër KKTK.01/21 të datës 27.01.2021; Kërkesën për sqarim me numër KKTK 10/21 të datës 29.01.2021; Vendimin me numër KKTK 02/18 të datës 29.01.2018; Raportin e Punës së Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë -KKTK për periudhën 218-21; Emalin e datës 09.09.2021 të drejtuar Emalin e datës 09.09.2021 të drejtuar Vendimin me numër Akti.Nr.14/21 të datës 09.09.2021; Akt emërimin me numër AE.Nr.4/2021 të datës 09.09.2021; Vendimin me numër A.nr.902/2021 të datës 12.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 04.08.2022 të drejtuar Emalin e datës .22.09.2022 me numër të protokollit 5614/2022; Aktgjykimin me numër A.nr.182/18 të datës 24.03.2021; Vendimin me numër A.nr.266/2021 të datës 05.05.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5154/2022 të datës 05.09.2022; Përgjigjen në



ankese me numër te protokollit 5432/2022 të datës 16.09.2022; Vendimin me numër të protokollit 3510/2018 të datës 22.06.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 02.02.2022 të drejtuar KPMSHCK-se; Emalin e datës 21.02.2022 të drejtuar Emalin e datës 15.0.2022 të drejtuar Aktgjykimin me/ numër AA.nr. 574/2021 të Gjykatës se Apelit të Kosovës; Vendimin me numër Akti. Nr.16/2022 të datës 28.07.0022; Vendimin me numër 69/2022 të datës 08.08.2022 i Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër VK.nr.123/2022 të datës 14.10.2022; Vendimin me numër 902/2021 të datës 17.12.2021 i Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktgjykimit A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 24.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, sikurse edhe bazës së të dhënave arkivore të Këshillit lidhur me ankesat e kaluara që mund të kenë ndërlidhje me shqyrtimin e kësaj ankesë, ka konstatuar se ankuesi fillimisht sipas Vendimit të datës 29.01.2018 ishte emëruar Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa kundër procedurës së përzgjedhjes së ankuesit në pozitën Udhëheqës Ekzekutiv, kishte parashtruar ankesë në Këshill ankuesja me datë 03.05.2018, ndërsa Këshilli me datë 19.06.2018 kishte nxjerrë vendimin A.nr.257/2018 përmes të cilit e kishte aprovuar ankesën e ankueses ndërsa e kishte shfuqizuar Vendimin e datës 04.04.2018 me numër:1107 të Komisionit për Ankesave për Pozita të Larta Drejtuese i Ministrisë së Administratës Publikë, kurse procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës Ekzekutiv i Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore" në të cilën ishte zgjedhur ankuesi e kishte anuluar.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në cilësi të palës në procedurë, kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kundër Vendimit të Këshillit me shifër A.nr.257/2018 të datës 19.06.2022, ndërsa Gjykatat Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 24.03.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.1827/18 përmes të cilit e kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit-Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, kurse e kishte anuluar vendimin e Këshillit të datës 19.06.2018 më shifër A.nr.257/2018 dhe lëndën e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i paditur.

Mirëpo, pala e interesit, ankuesja të cilës i ishte aprovuar ankesa sipas Vendimit të këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të datës 19.06.2018 me numër A.nr.257/2018, kundër Aktgjykimit A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar padi në Gjykatën e Apelit të Kosovës me datë 27.04.2018. Gjykatat e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me datë 07.06.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.574/2021 përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës së interesit duke e ndryshuar Aktgjykimin A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa e refuzon si të pa bazuar kërkesë padinë e palës paditëse Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore



për lënien në fuqi të vendimit të datës 29.01.2018 dhe anulimin e Vendimit të Këshillit A.nr.257/2018 i datës 19.06.2018.

Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.574/2021 të datës 07.06.2022, me datë 03.08.2022 ka marr Vendimin me numër Akti.Nr.17/2022 përmes të cilit e ka anuluar Vendimin me Nr.14/2021 të datës 09.09.2021 për emërimin e ankuesit në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e shqyrtimit të ankesës së tij, ta anuloj vendimin Akti.nr.17/2022 të datës 03.08.2022 si dhe ta detyroj Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore të bëjë zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së A.nr.902/2021 të datës 17.12.2021 dhe të më kompensoj diferencën në pagë sipas këtij vendimi nga muaji shtator 2021, janë të paqëndrueshme, ngase Vendimi me Nr.14/2021 i datës 09.09.2021 i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore sikurse edhe Vendimi A.nr.902/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 17.12.2021 janë nxjerrë në frymën e dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë nenit 83 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton që: *"Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës"* si dhe nenit 42 paragrafit 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *"Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale"*, ngase pavarësisht që sipas Vendimit të Këshillit të datës 19.06.2018 me numër A.nr.257/2018 pozita e Udhëheqësit Ekzekutiv në të cilën ishte përzgjedhur ankuesi ishte anuluar, i njëjti kishte vazhduar ta ushtrojë detyrën e tij deri në vendosjen meritore nga Gjykatat Themelore në Prishtinë, respektivisht Gjykatat e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative.

Andaj Kolegji i Këshillit thekson faktin se pretendimet ankimore të ankuesit cili pretendon që të realizojë të drejta të cilat kanë rrjedh apo janë derivat i Vendimit të datës 19.01.2018 përmes të cilit ankuesi ishte emëruar Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, ngase Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit A.nr.574/2021 me datë 07.06.2022, përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës së interesit duke e ndryshuar Aktgjykimin A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesë padinë e palës paditëse-Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për lënien në fuqi të vendimit të datës 29.01.2018, rrjedhimisht Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj ka vërtetuar ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit A.nr.257/2018 të datës 19.06.2018 përmes të cilit ishte konstatuar fakti se procedura e rekrutimit për Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në të cilën procedurë ishte përzgjedhur ankuesi Isuf Koci, ishte zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit material, respektivisht në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës



132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.753/2022

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.